

VENDIM
Nr.190, datë 10.4.2004

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.550, DATË 1.8.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA
SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 67 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tabelën “Lista e tarifave të shërbimit të zyrave të gjendjes civile”, që i bashkëlidhet vendimit nr.550, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Certifikatë për lidhje martese në gjuhë të huaja 200 lekë.”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Certifikatë lindjeje në gjuhë të huaja 200 lekë.

5. Certifikatë martese në gjuhë të huaja 200 lekë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano